REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Statistikat vendore

- **Kompetencat**

Sektori i Statistikave është përgjegjës për:

- Identifikimin e mundësive për krijimin e një klime të favorshme për biznesin e vogël e mesëm.
- Analizimin e informacioneve ekonomike lidhur me planifikimin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin.
- Raportimin për situatën ekonomike ,sociale, kulturore në sektorët përgjegjëse, brenda dhe jashtë bashkisë.
- Krijimin dhe mbajtjen e kontakte të vazhdueshme me zyrat analoge pranë institucioneve të tjera (INSTAT, Ministri) ,organizma të huaj e subjekte privat etj.
- Grumbullimin e informacionit nga Njësitë Administrative për efekte statistikore dhe informimi.
- Grumbullimin në mënyrë periodike (3,6,9,12) mujore të të dhënave nga drejtoritë e Bashkisë për efekt informimi.
- Studimin e tregut të punës dhe mundësitë për punësim të banorëve të Bashkisë.
- Krijimin dhe ofrimin e instrumentave me karakter informues(broshura,portale,manuale).

- **Struktura përgjegjëse**

Sektori i Statistikave ushtron kompetencat e mësipërme në varësi të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Pronave Publike dhe Financës. Ky sektor mbulohet nga dy punonjës:

-Përgjegjësi i Sektorit

-Specialisti

- **Statistika të përgjithshme**

Bashkia Prrenjas me planin e ri territorial të miratuar më 31 korrik 2014 nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në

(Date 03/10/2019)

Te dhena rreth Prrenjasit

33031

Banore

322.95

Siperfaqja ne km2

77

Densiteti ne banorë/km2

4

Njësi administrative

1

Qytet

25

Fshatra

5.45 Bashkia Prrenjas

Gjatë vitit 2018, bashkia Prrenjas me një popullësi prej 33,064 banorë, ka realizuar 48,430 mijë lekë të ardhura, të cilat zënë 0.20 % të të ardhurave të mbledhura nga bashkitë, duke e renditur bashkinë Prrenjas në vendin e 44, të renditjes së bashkive sipas realizimit të të ardhurave. Në realizimin e të ardhurave, 38,552 mijë lekë, ose 79.6 % janë të ardhura tatimore. Krahasuar me vitin 2017, të ardhurat e vitit 2018 të bashkisë Prrenjas janë ulur me 3.26 %. Taksat kryesore të cilat zënë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave të veta janë: Taksa mbi ndërtesën të cilat zënë 6.1 % të totalit; taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja të cilat zënë 5.8 % të totalit; taksa mbi tokën bujqësore të cilat zënë 4.8% të totalit. Më konkretisht, të ardhurat e vitit 2018 të bashkisë Prrenjas, paraqiten sipas tabelës së parë.

(mijë lekë)

Lloji i Taksës	Të ardhurat 2017	Të ardhurat 2018
Taksa mbi ndërtesën	2,585	2,934
Taksa mbi tokën bujqësore	2,334	2,322
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	0	16
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	8,445	2,802
Taksa e fjetjes në hotel	0	6
Taksa e tabelës	1,169	813
Taksa vendore të përkohshme	0	352
Taksa mbi biznesin e vogël	407	614
Taksa të tjera	9,760	20,046
Tarifa vendore për zënien e hapësirave publike	1,842	1,744
Tarifa e pastrimit dhe higjienës	5,754	6,071
Taksa vendore e gjelbërt	1,001	832
Të ardhura jo Tatimore	16,764	9,878
TOTALI	**50,063**	**48,430**

Nga ana tjetër në vitin 2018 Bashkia Prrenjas ka realizuar 316,788 mijë lekë shpenzime. Në krahasim me vitin 2017 këto shpenzime janë ulur me rreth 4,341 mijë lekë, ku në vitin 2017 ato ishin rreth 321,129 mijë lekë. Në tabelën e dytë, jepen shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik.

(mijë lekë)

Shpenzimet e NJQV-s sipas natyrës	Realizimi faktik		Diferencat vjetore	Raporti i ndryshimit
	2018	2017		
Shpenzime Korrente	238,909	196,162	42,747	122%
Personeli	161,621	138,941	22,681	116%
Operative	67,438	54,067	13,371	125%
Te tjera	9,849	3,154	6,695	312%
Shpenzime kapitale	77,879	124,967	-47,088	62%
TOTALI	316,788	321,129	-4,341	99%

Për vitin 2018, Bashkia Prrenjas ka kryer 9.6 mijë lekë shpenzime për banor, nga të cilat 4.9 mijë lekë shpenzime personeli për banor dhe 2.4 mijë lekë shpenzime për investime për banor.

Pesha që zënë shpenzimet faktike të personelit ndaj shpenzimeve faktike totale për vitin 2018 është rreth 51 %, shpenzimet operative faktike zënë rreth 21% ndaj totalit të shpenzimeve, ndërsa ato për investime rreth 25%. Këto shpenzime, janë mbuluar me transfertën e pakushtëzuar, transfertën specifike dhe nga të ardhurat e veta. Raporti i ndryshimit të shpenzimeve sipas llogarive ekonomike për vitet 2018 dhe 2017 jepet si në grafik.

